

Les Bibliothèques de la Ville de Lausanne

Informations pratiques

(albanais)

Bibliotekat e qytetit të Lozanës
Informacione për përdorimin e bibliotekës



Ville de Lausanne
Les bibliothèques

Bibliotekat e qytetit të Lozanës

Informacione për përdorimin e bibliotekës

Ky dokument shpjegon rregulloren e bibliotekave.

Ai ju shpjegon si ti përdorni me lehtësi bibliotekat e Qytetit të Lozanës.

Lënda

Informacione për përdorimin e bibliotekës	2
Siti Internet i bibliotekave : bavl.lausanne.ch	4
Çfarë mund të bëni në bibliotekat tona ?	5
“Lire à Lausanne” (Të lexosh në Lozanë).....	7
Adresat dhe oraret	7
Tarifat.....	9
Humbje ose dëmtime	11
Shpenzime të tjera	12

Informacione për përdorimin e bibliotekës

Sa dokumente mund të huazoni ?

Dokument quhet për shembull një libër, një DVD apo një revistë.

Nga tetori deri në maj, ju mund të huazoni **20 dokumente**

Gjatë verës (nga 1 qershor deri në 30 shtator) : mund të huazoni **30 dokumente**.

Për sa kohë ?

Ju mund të huazoni dokumente **për 28 ditë**.

Ju mund ta zgjasni **1 herë** afatin e mbajtjes.

Ku duhet t'i ktheni dokumentet ?

Keni huazuar dokumente në një Bibliotekë të Qytetit të Lozanës ?

Atëherë ju lutem t'i ktheni :

- Drejtpërdrejt në njërin prej **bibliotekave**
- Ose në **kutitë e kthimit** (jashtë orarit të hapjes).

Sa kushton ?

Regjistrimi dhe huazimi i dokumenteve janë **falas**.

Por biblioteka këkon **respektin e kushteve të përdorimit**.

Për shembull :

- Nëse një dokument kthehet me vonesë, paguhen **shpenzime vonese**.
- Nëse një dokument humbet apo dëmtohet, duhet paguar për ndreqjen apo zëvendësimin e tij. Në një rast të tillë, dokumentin e ri e blen biblioteka.

Informacione për përdorimin e bibliotekës

A mund të zgjatet afati i mbajtjes së një dokumenti të huazuar ?

Po, mund të zgjatet e shumta **1 herë**. Për 28 ditë të tjera.

Nëse dokumenti **nuk** është **rezervuar** nga një njeri tjetër, ju mund ta zgjasni afatin:

- me telefon në numrin 021 315 69 15
- me e-mail : bibliotheques@lausanne.ch
- përmes sitit tonë Internet : bavl.lausanne.ch
- ose përmes pikave të huamarrjes në bibliotekë.

A mund të rezervohet një dokument ?

Po, ju mund të rezervoni një dokument **tashmë të huazuar** nga një njeri tjetër.

Eshtë falas. Për të rezervuar, shkoni në sitin e bibliotekës :
bavl.lausanne.ch

Për të rezervuar një dokument që ndodhet **në raft**, lutemi t'i drejtoheni dikujt në sportel.

Lidhje për kushtet e përdorimit

Për rregulloren : www.lausanne.ch/bibliotheques-reglement

Për tarifatat : www.lausanne.ch/bibliotheques-tarifs

Siti ynë

bavl.lausanne.ch



Siti Internet i bibliotekave : bavl.lausanne.ch

Çfarë informacione mund të gjej në portalin e bibliotekave ?

Ju mund të gjeni :

- **libra ose DVD** në katalogun tonë elektronik
- **adresat dhe oraret** e bibliotekave të rrjetit,
- si dhe të gjitha informacionet e rëndësishme.

Çfarë mund të bëj në këtë sit ?

Në këtë portal, ju mund :

- **të administroni llogarinë tuaj** nga banesa juaj
- të verifikoni huazimet tuaja
- të rezervoni dokumente tashmë të huazuara
- të gjeni ide për lexim.

Në këtë sit, ju do të gjeni edhe :

- mundësi për t'u formuar
- gazeta në linjë
- libra elektronike.

Çfarë mund të bëni në bibliotekat tona ?

Keni një pyetje ?

Kërkoni një libër për një temë të veçantë ?

Personeli i bibliotekës është i gatshëm për t'ju këshilluar.

Në bibliotekat e Lozanës,

ju mund të bëni gjëra të ndryshme :

- 1. Të zbuloni dokumente interesante**
- 2. Të punoni në qetësi**
- 3. Të shikoni filma**
- 4. Të hyni në internet**

Të zbuloni dokumente interesante

Në bibliotekat tona, ka mbi 220'000 dokumente.

Për të rritur dhe për të vegjëlit, qysh nga lindja.

Këto dokumente, ju do t'i gjeni :

- në qasje të lirë, drejtpërdrejt në rafte
- ose, duke i rezervuar në linjë.

Ka :

- romane
- banda të vizatuara dhe manga
- gazeta dhe revista
- libra audio
- koleksione me DVD dhe Blueray

si dhe :

- libra në gjuhë të ndryshme
- dhe dokumente informuese në të gjitha fushat.

Çfarë mund të bëni në bibliotekat tona ?

Të punoni në qetësi

Në sallat tona, ju mund të vini për të punuar dhe studjuar në qetësi.

Kjo ndihmon për t'u përqendruar.

Të shikoni filma dhe Të hyni në internet

Në bibliotekat tona, ju mund gjithashtu :

- të shikoni DVD
- të ndiqni një kurs gjuhe në CD
- të përdorni një lexues multimedia portativ me kufje audio (Për këtë ju duhet të depozitoni **letërnjoftimin** tuaj)
- me një kabëll "jack" të dyfishtë, të shikoni një film ose seri TV **vet i dytë**
- të hyni në Internet duke huamarë një tabletë me prekje.

Hyrja në Wi-Fi-në e Qytetit të Lozanës është **falas**.

Keni harruar kufjet ?

S'ka problem, ju huazojmë ne kufje audio.

Ju mund ta përdorni këtë material lirshëm **brenda bibliotekave tona**.

Për më tepër informacione, mos nguroni t'u drejtoheni bibliotekave !

“Lire à Lausanne” (Të lexosh në Lozanë)

“Lire à Lausanne” është një program veprimtarish kulturore për të vegjlit dhe për të rriturit.

“Lire à Lausanne” ju propozon veprimtari përgjatë tërë vitit.

Gjithçka është falas !

Ju mund ta kërkonti **kalendarin kulturor** të programit “Lire à Lausanne” në bibliotekë. Ose t’i merrni informacionet çdo muaj drejtpërdrejt me “e-mail” !

Adresat dhe oraret

Bibliobusi

Disa stacione në Lozanë

079 622 63 74

Oraret dhe stacionet : www.lausanne.ch/bibliobus

Biblioteka Chailly

Avenue de la Vallonnette 12

1012 Lausanne

021 315 69 70

E hënë, e martë, e premte : 13.30-18.30

E mërkurë : Ora 10 -13, 13.30-19

Biblioteka Chauderon

Place Chauderon 11

1003 Lausanne

021 315 69 15

E hënë, e martë, e mërkurë, e enjte, e premte : Ora 12 – 19

E shtunë : Ora 11 – 17

Biblioteka Entre-Bois

Chemin d’Entre-Bois 10

1018 Lausanne

021 315 69 18

E hënë, e martë, e enjte, e premte : Ora 14 – 19

E mërkurë : Ora 12 – 19

Biblioteka Jeunesse

Avenue d'Echallens 2A

1004 Lausanne

021 315 69 17

E hënë, e premte : Ora 15 – 18

E hënë, e mërkurë, e enjte : Ora 10 -12, 15-18

E shtunë : Ora 10 – 16

Biblioteka La Sallaz

Place de la Sallaz 4

1010 Lausanne

021 315 69 90

E hënë, e martë, e enjte, e premte : Ora 14 – 19

E mërkurë : Ora 12 – 19

Biblioteka Montriond

Avenue F—de-la-Harpe 2bis

1007 Lausanne

021 315 69 80

E hënë, e martë, e premte : Ora 14 – 19

E mërkurë, e enjte : Ora 10 -12, 14-19

Tarifat

Abonimi « visiteur » (vizitor) (neni.13)

Abonimi « visiteur »	Nën moshën 18 vjeç	Mbi 18 vjeç
Garanci	x	Frz 100.-

Shpenzime për vonesë

Nëse i ktheni dokumentet me vonesë, duhet të paguani :

	Nën moshën 16 vjeç		Mbi 16 vjeç	
Një javë vonesë	Paguhet më tepër	Shuma që duhet të paguhet	Paguhet më tepër	Shuma që duhet të paguhet
Javën e 1 ^{re} të vonesës : kujtesë me shkrim	-	Frz 2.-	-	Frz 4.-
Javën e 2 ^{te} të vonesës : rikujtesë me shkrim	Frz 2.-	Frz 4.-	Frz 4.-	Frz 8.-
Javën e 3 ^{te} të vonesës	Frz 2.-	Frz 6.-	Frz 4.-	Frz 12.-
Javën e 4 ^{te} të vonesës	Frz 2.-	Frz 8.-	Frz 4.-	Frz 16.-
Javën e 5 ^{te} të vonesës : rikujtesë me shkrim	Frz 4.-	Frz 12.-	Frz 8.-	Frz 24.-
Javën e 6 ^{te} të vonesës	Frz 4.-	Frz 16.-	Frz 8.-	Frz 32.-

Javën e 7 ^{të} të vonesës	Frz 4.-	Frz 20.-	Frz 8.-	Frz 40.-
Javën e 8 ^{të} të vonesës : rikujtesa e fundit me shkrim nga ana jonë	Frz 8.-	Frz 28.-	Frz 16.-	Frz 56.-
Javën e 9 ^{të} të vonesës	Frz 8.-	Frz 36.-	Frz 16.-	Frz 72.-
Javën e 10 ^{të} të vonesës : faturë për t'u paguar	Frz 8.-	Frz 44.-	Frz 16.-	Frz 88.-



Humbje ose dëmtime

Nëse humbisni apo dëmtoni një dokument, duhet të paguani çmimin e tij dhe shpenzime shtesë :

Çmimi i dokumentit	Nën moshën 16 vjeç	Mbi 16 vjeç
Më pak se Frz. 10.-	Frz 1.-	
nga Frz 10.- në 29.-	Frz 4.-	
nga Frz 30.- në 59.-	Frz 8.-	
nga Frz 60.- në 89.-	Frz 12.-	
duke filluar nga Frz 90.-	Frz 20.-	
Gazeta	Frz 3.-	Frz 5.-
Revista	Frz 8.-	Frz 10.-

Keni humbur një dokument ?

I keni paguar **tashmë** shpenzimet ?

Nëse e rigjeni dokumentin **në gjendje të mirë**, mund ta bini në bibliotekë, brenda 30 ditëve.

Paraqisni fletarkëtimin e pagesës.

Biblioteka jua kthen gati tërë shumën. Ajo mban Frz 10.-

Pas 30 ditësh, ajo mban Frz 15.-

Shpenzime të tjera

Shpenzime të tjera	Nën moshën 16 vjeç	Mbi 16 vjeç
Ne duhet ta zëvendësojmë kartën tuaj	Frz 5.-	Frz 10.-
Ne duhet të kërkojmë adresën tuaj, sepse ju nuk e keni dhënë atë	Frz 5.-	Frz 8.-
Nuk keni ardhur të tërhiqni një dokument të rezervuar	Frz 2.-	
Ne duhet të zëvendësojmë një etiketë të dëmtuar ose të humbur	Frz 4.-	Frz 6.-
Ne duhet të zëvendësojmë kutinë apo xhepin e një CD-je	Frz 1.-	Frz 2.-

Pas 10 javësh vonesë të dokumentit të parë, ne duhet të bëjmë një faturë dhe t'jua dërgojmë.	Frz 50.-
Dhe shpenzimet për çdo dokument shtesë	Frz 10.-
Për çdo dokument tjetër, ne duhet të bëjmë një faturë dhe t'jua dërgojmë	Frz 30.-
Nëse ju keni humbur apo dëmtuar një aparat (tabletë apo lexues)	Çmimi i aparatit të ri (e shumta. Frz 600.-)
Nëse ju keni humbur apo dëmtuar një këllëf tablete	Frz 50.-

Siti i bibliotekave : bavl.lausanne.ch

FB “Lire à Lausanne”

YouTube “Lire à Lausanne”

Përshtatje e rregullores në formë të thjeshtë për t'u lexuar lehtë: Zyrë gjuhe të thjeshtësuar, Pro Infirmis

